



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr. 4078 Prot

Elbasan më 15 /07/2026

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin QERSHOR 2026

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Propozojmë:

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin QERSHOR 2026 gjithsej 73 familje me një fond gjithsej 214.820 lekë.
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit.
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjelltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Pergj sektori
Pranoi: Dr Pergjithshem

M.Duka
D.Shuli

Zv/kryetari

Klaudia Krasnika





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/07/ 2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë ____/07/ 2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin QERSHOR 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 3 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/07/2026

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin QERSHOR 2026 për 73 familje me një fond prej 214.820 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Miratoi: Dr Përgjithshëm
Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr.Finance
Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka
D.Shuli
E.Arapi
A.Merkja
K.Krasnika

Sekretar i Këshillit Bashkiak
Elsid Zyma

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENSIA E SHËRBIMEVE SOCIALE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Nr.Prot 4080

Elbasan më 15 /07/2026

RELACION

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin QERSHOR 2026
KËSHILLIT BASHKIAK**

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, paraqesim për miratim propozimin e familjeve që do trajtohen nga fondi i kushtëzuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar për muajin QERSHOR 2026 ,
246 familje me një fond prej 1.152.571 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose meshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .

Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: Përgj Sektori
Pranoi: Dr Përgjithshëm

M.Duka
D.Shuli

ZV/ KRYETARI

Klaudia Krasniqa





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. _____ Prot

Elbasan më ____/07/2026

PROJEKT – VENDIM

Nr. ____ datë ____/07/2026

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin QERSHOR 2026

Bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 4 datë 28.01.2026 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike” Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____/07/2026 pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga Drejtoria e Shërbimit Social

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin **QERSHOR 2026** për 246 familje me një fond prej **1.152.571** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konceptoi: Përgj sektori
Pranoi : Dr Përgjithshëm
Drejtor Dr Juridike
Drejtor Dr Finance
Konfirmoi: Zv/Kryetar

M.Duka
D.Shuli
E.Arapi
A.Merkja
K.Krasnika

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elsid Zyma

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA PRONAVE PUBLIKE DHE STREHIMIT

Nr. 4082 Prot.

Elbasan, më: 15.07.2026.

R E L A C I O N

“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr. 7/40, ndodhur në Z.K. 8525, Lagja “Haxhias”, nga “Lulishte” në “Rrugë”, Bashkia Elbasan”.

KËSHILLIT BASHKIAK
K Ë T U

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”; V.K.M. nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, i relatojnë Këshillit Bashkiak si në vijim:

Bashkia Elbasan, bazuar në Vendimin nr. 1415 (80-2025-1409) datë 25.04.2025, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me objekt “Për lirim dhe sitemimin e plotë të hapësirës publike pasuria nr.7/40 , ZK 8525, Lagja “Haxhias” me emërtimin “Lulishte” në pronësi të Bashkisë Elbasan”, si dhe në kërkesën e banorëve të lagjes “Haxhias”, nr. 1529 Prot, datë 01.07.2026, me objekt “Zbatim Vendimi”, ka konstatuar nevojën për rishikimin e funksionit të kësaj pasurie.


Duke qënë se pasuria në fjalë shërben realisht si rrugë kalimi e cila siguron aksesin e banorëve drejt banesave të tyre dhe në kuadër të zbatimit të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, Bashkia Elbasan ka filluar procedurën për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr.7/40, ndodhur në Z.K. 8525, nga “Lulishte” në “Rrugë”.

Për sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë fillimin e procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr.7/40, ndodhur në Z.K. 8525, nga "Lulishte" në "Rrugë".

KRYETARI

Gledian Llatja

Me urdhër e porosi
ZV/KRYETAR
Klaudia Krasnika



Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria F.B.:

Drejtoria P:

Drejtoria D.P.Zh.T.P.P

Drejtoria e P.SH.M:

A. Pisha

G.Dyrmyshi

A. Merkja

M. Avllazagaj

K.Haxhihysen

S.Mehmeti

Xh. Qosja



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më: ____ .07.2026.

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____ Datë: ____ .07.2026.

“Mbi miratimin e fillimit të procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr .7/40, ndodhur në Z.K. 8525, Lagja “Haxhias”, nga “Lulishte” në “Rrugë”, Bashkia Elbasan ”.

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin Nr. 8744, datë 22.01.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësinë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; V.K.M nr. 28 datë 27.01.2023 “Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve”; V.K.M. nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .07.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse:

VENDOSI:

1. Miratimin për fillimin e procedurave për përditësimin dhe ndryshimin e zërit kadastral të pasurisë nr. 7/40, ndodhur në Z.K. 8525, Lagja “Haxhias”, nga “Lulishte” në “Rrugë”, Bashkia Elbasan, duke qënë se pasuria në fjalë shërben realisht si rrugë kalimi e cila siguron aksesin e banorëve drejt banesave të tyre.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe vazhdimësinë e procedurës së mëtejshme ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të Territorit dhe Punëve Publike si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elsid Zyma

KRYETARI

Lutfi Lala

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria F.B.:

Drejtoria P:

Drejtoria D.P.Zh.T.P.P

Drejtoria e P.SH.M:

Drejtoria J. I:

Zv/Kryetar:

A. Pisha

G.Dyrmyshi

A. Merkja

M. Avllazagaj

K.Haxhiyseni

S.Mehmeti

F.Arapi

K.Krasnika

Xh.Qosja



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

Nr. 4102 prot.

Elbasan me 16.07.2026

RELACION

“Mbi miratimin e Tavanëve Përfundimtarë të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029”

Drejtuar : Këshillit Bashkiak Elbasan

Z. Këshilltarë !

Bazuar në ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimin nr.7, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029”, janë miratuar nga ju “Tavanet Përgatitore të Shpenzimeve, të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029, si dhe faza e parë e “Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029”, përkatesisht me vendimet nr.42, datë 27.03.2026, dhe nr.91, datë 25.06.2026.

Sipas këtyre udhëzimeve, muaji korrik është periudha e miratimit të tavanëve përfundimtare të shpenzime afatmesme.

Në këtë fazë nuk kemi ndryshime të të ardhurave apo shpenzimeve, miratuar nga ju me vendimet e sipërpërmëndur, me përjashtim të transfertës së pakushtëzuar sektoriale. Në hartimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve, niveli i kësaj transferte u bazua në të dhënat e Udhëzimit nr.7, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029”, ndërkohë në sistem kjo transfertë rezulton 15,548 mijë lekë me pak në vitin 2028 dhe 15,703 mijë lekë më pak në vitin 2029.

Për këto arsye kërkojme miratimin tuaj në lidhje me paksimin e këtyre fondeve grant, (transferte sektoriale) për periudhën 2028 dhe 2029, e rrjedhimisht reflektimin e tyre në tavanet përfundimtare të shpenzimeve afatmesme 2027-2029.

Si pasojë e këtyre ndryshimeve, tavanet përfundimtarë të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029, rezultojnë si më poshtë :

	viti 2027	viti 2028	viti 2029	(mijë lekë)
Ishte:	3,885,597	3,999,583	4,107,053	
Bëhet:	3,885,597	3,984,035	4,091,350	
Diferenca:	0	15,548	15,703	


Bashkëlidhur vendimit keni tabelën “Tavanet përfundimtarë të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029”, reflektuar ndryshimet e mësipërme.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P/Sekt.Buxh : M.Behluli
D.Buxh.Fin.: A.Merkja
D.P.Sh.M: S. Mehmeti
D.P.K.S.A.R.S: D.Rroseni
D.P.M.C.M.B.P: Sh. Çullhai



ZV/ KRYETAR
Klaudia Krasnika





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Datë ____ .07. 2026

P/VENDIM

NR. _____, DATË ____ . 07. 2026

MBI

**“TAVANET PËRFUNDIMTARE TË SHPENZIMEVE, TË PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2027-2029”**

Këshilli Bashkiak i Qytetit Elbasan i mbledhur sot më datë ____ . 07. 2026, pasi mori në shqyrtim materialet e përgatitura nga Bashkia e Qytetit Elbasan, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Elbasan, mbi “Miratim i tavanëve përfundimtare të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm 2027-2029”, mbështetur në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Udhëzimin nr.23, datë 30.07.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të programit buxhetor afatmesëm të njësisë të vetëqeverisjes vendore”, si dhe Udhëzimin nr.7, datë 27.02.2026 të Ministrisë së Financave “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2027-2029”,

VENDOSI :

1. Miratimin e tavanëve përfundimtare të shpenzimeve, të programit buxhetor afatmesëm për tre vitet e ardhshme 2027-2029, sipas materialit bashkëngjitur këtij vendimi.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Grupi për Menaxhimin Strategjik.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR
Elsid Zyma

KRYETAR
Lutfi Lala

P/ Sekt.Buxhetit.: M.Behluli

Dr.Buxhet Fin.: A.Merkja

D.P.Sh.M: S. Mehmeti

D.P.K.S.A.R.S: D.Rroseni

D.P.M.C.M.B.P: Sh. Çulhaj

Dr.Juridike: E. Arapi

Zv/kryetar : K. Krasnika



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
AGJENCIA E MBIKËQYRJES DHE KONTROLLIT

Nr. 4095 Prot.

Elbasan, më 16.07.2026

RELACION

“Për ngritjen e një stacioni të Ri zjarrfikës me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës, në territorin e Bashkisë Elbasan, si dhe një shtesë me 10 punonjës operacional në organikën e Drejtorisë së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”

KËSHILLIT BASHKIAK

Të nderuar Këshilltarë,

Drejtoria e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtim, aktualisht është e organizuar me një stacion zjarrfikës i pajisur me mjetet, pajisjet dhe personelin zjarrfikës të nevojshëm, sipas përcaktimeve ligjore. Aktualisht Shërbimi i MZSH në kapacitet e tij operacionale disponon: 6 automjete zjarrfikëse me pompë centrifugale, 1 autoskallë dhe një atobot uji 14 ton. Ka një personel prej 42 punonjësish; 1 Drejtori i SHMZSH, 1 Shef i sektorit për ndërhyrjen dhe shuarjen e zjarreve, 1 shefi i parandalimit, 1 drejtues i shuarjes së zjarreve, 4 punonjëse të sallës së informacionit, 4 komandant shërbimi, 12 luftues, shpëtues, drejtues automjeti, 19 luftues, shpëtues. Të gjitha pozicione pune të parashikuara sipas VKM nr. 520, datë 25.07.2019 “Për miratimin e rregullores së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 29, pika 2 e tij, “Funksionet e bashkive në fushën e sigurisë publike”, parashikon garantimin e shërbimit zjarrfikës në nivel vendor, ligjit 152/2015 “për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, neni 7, pika 2 e tij, parashikon “1 zjarrfikës profesionist për 1500-2000 banorë, si dhe të nenit 16 të VKM nr.520, datë 25.07.2019 “për miratimin e rregullores së shërbimit të MZSH”, ku parashikohet se njësite e vetëqeverisjes vendore mund të kenë më shumë se një stacion zjarrfikës në territorin e tyre.

Kërkohet:

1. Në territorin e Bashkisë Elbasan të ngrihet një stacion i Ri zjarrfikës, me objektin e përshtatshëm, me mjetet, pajisjet dhe personelin zjarrfikës. Me vendndodhje në Njësia Administrative Bradashesh, pranë godinës së njësies Administrative.
2. Për funksionimin normal të proceseve të punës si dhe garantimin e gatishmërisë së stacionit kërkohet një shtesë prej 10 punonjësish në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Drejtorisë së shërbimit të MZSH, në varësi të së cilës do jetë dhe stacioni i Ri.

Për ngritjen dhe funksionimin e stacionit zjarrfikës do të zbatohen kriteret ligjore si më poshtë:
a) 2 (dy) automjete zjarrfikëse me kapacitet jo më pak se 2 000 (dy mijë) L ujë;

- b) pajisje të ndryshme zjarrfikëse rezervë (tuba të ndryshëm, hedhëse, lidhëse, qafëpatë, çelësa të ndryshëm hidranti, përzierësi i shkumës, shkumë, fikës zjarri të ndryshëm portativë të tipit të përshtatshëm, pajisje shpëtimi të ndryshme, lloje shkallësh të ndryshme etj;
- c) garazhe për automjete zjarrfikëse;
- ç) ambientet normale për funksionimin e shërbimit, zyra, magazinë, sallë trajnimit, ambiente ndenjeje etj;
- d) Stacionet zjarrfikëse do të kompletohet dhe do të përdor pajisje zjarrfikëse të standardit "STROZ";
- dh) stacioni zjarrfikës do ketë një numër jo më pak se 13 punonjësish me këto funksione: 1 punonjës i nivelit të mesëm (shef sektori), 4 luftues, shpëtues, drejtues automjeti, 8 punonjës luftues, shpëtues.

Ngritja dhe funksionimi i stacionit të ri zjarrfikës kërkohet për këto arsye:

1. Rritja e kapaciteteve operacionale

Bashkia Elbasan ka investuar në vitet e fundit në përmirësimin e ndjeshëm të kapaciteteve operacionale të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, duke shtuar mjete të reja zjarrfikëse, pajisje dhe duke forcuar burimet njerëzore.

Këto investime kërkojnë një shpërndarje sa më drejtë në territorin e Bashkisë dhe nëpërmjet stacionit të Ri, shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin (SHMZSH), do të jetë sa më afër komunitetit duke ulur kohën e reagimit dhe rritjen e sigurisë publike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

2. Rritja e numrit dhe kompleksitetit të emergjencave

Numri i ndërhyrjeve është rritur jo vetëm për zjarret e rëna, por edhe për aksidente rrugore, përmbetje, incidente teknologjike dhe emergjenca të tjera civile.

Një stacion i ri do të mundësonte reagim më të shpejtë dhe koordinim më të mirë të operacioneve, pikërisht për këto arsye stacioni zjarrfikës është parashkuar që të ngrihet në Njësia Administrative Bradashesh, sepse ul kohën e reagimit për rastet e zjarreve që ndodhin në rrugën Elbasan- Tiranë, i përgjigjet në kohë cdo rasti aksidenti automobilistik që mund të ndodh në këtë aks rrugor.

3. Përballimi i zjarreve masive

Ndryshimet klimatike kanë sjellë rritje të temperaturave dhe periudha më të gjata thatësire, duke shtuar rrezikun e zjarreve në sipërfaqet pyjore, kullota dhe sipërfaqe bujqësore.

Zjarret me përmasa të mëdha kërkojnë mobilizim të shpejtë dhe kohë reagimi sa më shpejtë, dhe kjo arrihet pikërisht me ngritjen e stacionit të Ri në vendin e propozuar duke mbuluar me shërbim sa më të shpejtë të gjithë pjesën perëndimore të Bashkisë Elbasan, duke përfshirë Njësia Administrative Bradashesh, Gracen dhe Papër ku dhe sipërfaqet bujqësore dhe pyjore janë të konsiderueshme.

4. Prania e zonës industrial

Bashkia Elbasan përfaqëson një nga qendrat më të rëndësishme industriale në Shqipëri. Në territorin e bashkisë Elbasan ndodhen ish-Kombinati Metalurgjik, fabrika prodhuese, depo magazinimi, subjekte që përpunojnë metale, materiale ndërtimi, lëndë kimike, hidrokarbure, si dhe aktivitete të tjera industriale me potencial të lartë rreziku.

Këto aktivitete paraqesin një profil rreziku të ndryshëm nga ai i zonave të zakonshme urbane.

Në rast zjarri ose aksidenti industrial, pasojat mund të jenë shumë më të rënda, pasi përfshijnë:

- zjarre me intensitet dhe temperaturë shumë të lartë;

- shpërthime nga gazrat, karburantet ose substancat e ndezshme;
- rrjedhje të lëndëve kimike dhe ndotje të mjedisit;
- rrezik të drejtpërdrejtë për jetën e punonjësve dhe banorëve përreth;
- dëme të konsiderueshme ekonomike dhe ndërprerje të proceseve të prodhimit.

Aktualisht, zhvillimi i vazhdueshëm industrial dhe jo vetëm i Bashkisë Elbasan ka rritur ndjeshëm nivelin e ekspozimit ndaj këtyre rreziqeve. Për këtë arsye, infrastruktura ekzistuese e shërbimit zjarrfikës duhet të përshtatet për t'iu përgjigjur sfidave operacionale.

Për më tepër, zhvillimi ekonomik i Bashkisë Elbasan është i lidhur ngushtë me funksionimin e zonës industriale. Çdo incident i madh në këtë zonë mund të shkaktojë humbje të mëdha ekonomike, pezullim të aktivitetit të bizneseve, dëmtim të infrastrukturës dhe pasoja serioze për mjedisin.

Për këtë arsye, investimi në një stacion të ri zjarrfikës nuk është vetëm si një investim në sigurinë publike, por është dhe një investim strategjik për mbrojtjen e ekonomisë vendore, të investimeve private dhe të vazhdimësisë së aktivitetit industrial.

Ju faleminderit!

ZV/KRYETARI

Asim Sula



Konceptoi:

Dr. MZSH: E.Sota

DSHZ: K.Shinplaku

Shefi parandalimit: G.Ruda

Pranoi:

Dr. Përgjithshëm: L.Dervishi

Dr. JBNJ: E.Arapi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. _____ Prot.

Elbasan, më _____.____2026

PROJEKT-VENDIM

Nr. _____ datë _____.____2026

"Për ngritjen e një stacioni të Ri zjarrfikës me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës, në territorin e Bashkisë Elbasan, si dhe një shtesë me 10 punonjës operacional në organikën e Drejtorisë së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës _____.____.2026, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Agjencia e Mbikëqyrjes dhe kontrollit "Për ngritjen e një stacioni të Ri zjarrfikës me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës, në territorin e Bashkisë Elbasan, si dhe një shtesë me 10 punonjës operacional në organikën e Drejtorisë së shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", bazuar në ligjin nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe ligjin nr.152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";

VENDOSI:

1. Të miratojë ngritjen e stacionit të Ri zjarrfikës me mjete, pajisje dhe personel zjarrfikës, me vendndodhje Njësia Administrative Bradashesh pranë godinës së Njesisë Administrative.
2. Shtesë me 10 punonjës operacional në organikën e Drejtorisë së shërbimit të MZSH, për funksionimin e stacionit të Ri zjarrfikës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administratës dhe Burimeve Njerëzore, Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Kontrollit dhe Drejtoria e Shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Elsid Zyma

KRYETARI

Lutfi LALA